



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 882/5 Prot.

Durrës, më 13.03.2025

VENDIM

Nr. 30, datë 13.03.2025

PËR

**"MIRATIMIN E REDUKTIMIT TË TARIFËS SË STUDIMIT NË PROGRAMIN E
CIKLIT TË TRETË "DOKTORATË NË SHKENCA EDUKIMI" NË
UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; nenit 34 pika 1 gërma l të Statutit të UAMD-së; të Rregullores së UAMD-së; në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Edukimit me Nr. 696 Prot, datë 24.02.2025, vendimit të Senatit Akademik nr.19, datë 05.03.2025, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e reduktimit të tarifës vjetore të studimit me 70% (brenda kohës normale të studimeve) për studentët doktorantë të cilët janë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë ose personelit administrativ me kohë të plotë në UAMD, dhe vazhdojnë programin e studimit Doktoratë në "Shkenca Edukimi" pranë Fakultetit të Edukimit.
2. Ky reduktim do të përfitohet mbi kushtet e përcaktuara të një marrëveshje tip të nënshkruar mes studentit doktorant dhe UAMD
3. Studentit doktorant jashtë kohës normale të studimeve i lind detyrimi për pagesën e plotë të tarifës vjetore të studimit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:

- Administratori
- Drejtoria e Administrimit Financiar

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

